



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1037/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Milena Đerić kryesuese, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkritazi me apelin e kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit Florentina Vokshi nga Subjekti Politik Levizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1037/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit Florentina Vokshi nga Subjekti Politik Levizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë për rinumërimin në total të vendvotimeve në Gjilan 0430D/03D, 0429D/01D, 0422D/012, 0401D/02R, 0401D/08R, 0401D/11R, 0430D/01R, 0429D/01R, 0423D/02R, 0401D/03R, 0401D/00R, 0401D/12R, 0429D/02R, 0423D/03D, 0420D/01D, 0401D/05R, 0401D/07R, 0401D/13R, 0430D/02R.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit Florentina Vokshi nga Subjekti Politik Levizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, në të cilën kërkon rinumërimin e votave për rinumërimin në total të vendvotimeve në Gjilan: 0430D/03D, 0429D/01D, 0422D/012, 0401D/02R, 0401D/08R, 0401D/11R, 0430D/01R, 0429D/01R, 0423D/02R, 0401D/03R, 0401D/00R, 0401D/12R, 0429D/02R, 0423D/03D, 0420D/01D, 0401D/05R, 0401D/07R, 0401D/13R, 0430D/02R, për shkak të manipulimit me vota.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit Florentina Vokshi nga Subjekti Politik Levizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, ka

parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet për rinumërimin në total të vendotimeve në Gjilan

0430D/03D, 0429D/01D, 0422D/012, 0401D/02R, 0401D/08R, 0401D/11R, 0430D/01R, 0429D/01R, 0423D/02R, 0401D/03R, 0401D/00R, 0401D/12R, 0429D/02R, 0423D/03D, 0420D/01D, 0401D/05R, 0401D/07R, 0401D/13R, 0430D/02R, për shkak të manipulimit me vota. Si dëshmi nuk ka bashkangjitur asnjë fakt-provë me të cilën do të dëshmonte se ka ndodhur manipulimi.


Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1037/2021 më datën 07.11.2021

Kryesuesja e Panelit
Milena Đerić



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.